



## REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

### AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Nr.03-199

30.05.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (10 nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 14 paragrafi (1) dhe neni 29 nga Ligji për Medieme („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13 dhe 13/14), pika 3 dhe 14 nga Udhëzimi për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.03-1756/1 datë 6.4.2022, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 16-të mbajtur më 29.5.2023, në pajtim me Konkluzionin nr.02-2231/3 datë 30.5.2023 miratoi si vijon:

#### **Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, botues i „The Economist“, për shkeljen e kryer të nenit 14 paragrafi (1) të Ligjit për Medieme, në mënyrë që nuk ka përmbushur plotësisht detyrimin nga neni 14 paragrafi (1) të Ligjit për medieme, respektivisht në botimin nr.5 të „The Economist“ nga janari i 2023, nuk ka shpallur të dhënat për: adresë të selisë të botuesit të medias, adresë të shtypshkronjës, datën e botimit ose ribotimit dhe numrik e kopjeve të botimit.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-1756/1 datë 6.4.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, botues i „The Economist“, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për medieme.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si dita e miratit të tij konsiderohet dita e vërtetimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

#### **Arsyetim**

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencioni), në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe neni 29 të Ligjit për medieme është kompetent të kryen mbikëqyrje administrative për punën e botuesve të mediave në aspekt të harmonizimit të punës së tyre me detyrimet nga nenet 6, 8, 14 dhe 15 të Ligjit për medieme.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – aktvendim për vërejtje publike në pajtim me Ligjin, në rastet kur kemi të bëjnë me shkelje të dispozitave nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe akteve nënligjore, miratuar nga Ligji i njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve përcaktuar me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29 paragrafi (2) të Ligjit për medieme, masat që Agjencia si organ rregullator kompetent mund t'i ndërmarrë, dhe që janë të përcaktuara në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele zbatohen përkatësisht dhe në raste të shkeljes të dispozitave nga Ligji për medieme.

Agjencia në kuadër të kompetencave të veta ligjore, nëpërmjet Sektorit për planifik strategjik dhe të drejtat e autorit, më 6 mars 2023, ka krye mbikëqyrje të jashtëzakonshme administrative tek subjekti i mbikëqyrjes, botuesit të medias së shtypit Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, botues i „The Economist“ nga ku konstatoi shkelje të nenit 14 paragrafi (1) të Ligjit për medieme,

të mënyrës që Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, botues i „The Economist“ nuk ka përmbushur plotësisht detyrimin nga neni 14 paragrafi (1) të Ligjit për medime, respektivisht në botimin nr.5 të janarit 2023 të „The Economist“ nuk ka publikuar të dhënat për: adresë të selisë të botuesit të medias, adresë të shtypshkronjës, datën e botimit dhe ribotimit dhe numrin e kopjeve të botimit.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-1756/1 datë 6.4.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Këshilli i Agjencisë drejtuar Shoqërisë për prodhimtari, tregti dhe shërbime KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, botues i „The Economist“ më 10.4.2023, i dërgoi Shkresë PA1 nr.03-1756/2 datë 10.4.2023, ku i është dorëzuar Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-1756/1 datë 6.4.2023, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga Ligji për medime. Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, drejtuar Agjencisë dorëzoi Deklaratë me shkrim e vërtetuar si Nr.ynë ark.03-1756/3 datë 19.5.2023. Këshilli i Agjencisë në seancën mbajtur më 29.5.2023., pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe shkresën e dorëzuar – njoftim me shkrim dhe konkludoi ndaj Shoqërisë për prodhimtari, trgti dhe shërbime KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, t'i shqipton masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, dhe në lidhje me nenin 14 paragrafi (1) dhe neni 29 të Ligjit për medime, pika 3 dhe 14 të Rregullores për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022 dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.03-1756/1 datë 6.4.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të Ligjit për medime, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 16-të mbajtur më 29.5.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-2231/3 datë 30.5.2023 miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmërohet Shoqëria për prodhimtari, tregti dhe shërbime KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, botues i „The Economist“ dhe urdhërohet që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizon punën e tij me dispozitat nga Ligji për medime. Pas skadimi të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, veproi sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët (1) dhe (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij botuesi i medias së shtypur ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale,  
Kryetar i Këshillit  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi botuesi i medias së shtypit ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

**Shtojcë (1):**

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.03-1756/1 datë 6.4.2023.